



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhësi e Zbatuar**

Ngarkesa: 5 kredite; 60 orë mësimore; 45 leksione / 15 seminare

Viti / Semestri : Viti I ,semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Mësuesi e gjuhës italiane “

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë: Të ndërgjegjësohet për rëndësinë që ka Gjuhësia e zbatuar, jo thjesht si disiplinë gjuhësore, por si disiplinë e zbatueshme në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies; Të përftojë sa më mirë njohuritë në këtë disiplinë, duke ndërvepruar dhe punuar në mënyrë të pavarur; Të thellojë logjikën në perceptimin dhe interpretimin e nocioneve dhe tematikave të ndryshme nëpërmjet të mneduarit kritik.

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë:

- 1.Të njohë sa më mirë shkollat gjuhësore evropiane dhe ato amerikane në fushën e gjuhësisë, si edhe studjuesit dhe gjuhëtarët e këtyre shkollave;
- 2.Të fitojë kompetenca të thelluara gjuhësore, aq të domosdoshme për formimin e mësuesit të gjuhës italiane;